Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e ***anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik***, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP³.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

³ Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë.

- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 8/1

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;
- c. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;
- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës Nr.9, pika 1, Kriteret e Përgjithshme të Pranim/Kualifikimit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve (2017, 2018, 2019) të çertifikuar nga organet tatimore.
- 2. Xhiroja vjetore mesatare e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2017, 2018, 2019) duhet të jetë jo më pak se 30% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike.
- 3. Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore të Vitit 2020 (sipas kësteve) për të cilat duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.
- 4. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 30 % të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;
 - a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shënohen datat, shumat, emërtimet, vlerat dhe sasi të e mallrave ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat, sasi të, emërtimet, vlerat.
 - b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat, sasi të, emërtimet, vlerat.

2.3 Kapaciteti teknik:

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për mallrat objekt të prokurimit. Në rast paraqitje autorizimi distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një letër angazhim ose akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
- b) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- d) Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.
- e) Operatori ekonomik ofertues duhet paraqesë një deklaratë me shkrim që merr përsipër me mjetet e veta dhe me punonjësit e vet të realizojë shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në kohë dhe në sasi sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor në të gjitha objektet shkollorë nën administrim të autoritetit kontraktor në territorin e Bashkisë së Tiranës sipas planit të shpërndarjes i cili do t'i vihet në dispozicion nga autoriteti kontraktor ditën e lidhjes së kontratës.
- f) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qira të paktën 3 (tre) automjete për transport mallrash ATP (automjet i transportit të përzier), për dërgimin e mallrave objekt prokurimi në objektet shkollorë të Bashkisë së Tiranës sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Për vërtetimin e kësaj kërkesë duhet të paraqesë Çertifikatën e pronësisë, Lejen e Qarkullimit, Siguracionin dhe Kolaudimin të vlefshme për periudhën e realizimit të procedurës, ose në rast se nuk e ka mjetin në pronësi të paraqesë kontratën noteriale të marrjes me qira të tij si dhe dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e mjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin dhe Kolaudimin) të vlefshme për periudhën e realizimit të procedurës.
- g) Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi solucione dezinfektantë dhe antiseptikë (produktet me nr.1, 2, 3, 4 në tabelën e shtojcës Nr.12), duhet të paraqesë skedat teknike të sigurisë (MSDS) të publikuara nga prodhuesi/it dhe fletë analizat e lëshuara nga laboratorë të akredituar me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.
- h) Operatori ekonomik ofertues për produktin objekt prokurimi “Sapun i lëngshëm duarsh” (produkti me nr.1 në tabelën e shtojcës Nr.12), duhet të paraqesë raportin e testimit dermatologjik lëshuar nga laborator i akredituar bazuar në kërkesat e pikës 3 të Tabelës Nr.1 sipas Udhëzimit të Përbashkët Nr.294 datë 06.05.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë.
- i) Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi (produktet me nr.5,6,7,8,9,10 në tabelën e shtojcës Nr.12), duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut /eve të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi/it me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu

ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

- j) Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi (produktet me nr. 7,8,9,10 në tabelën e shtojcës Nr.12), duhet të paraqesë deklaratën e konfirmimit të lëshuar nga prodhuesi/sët për plotësimin e standarteve kombëtare ose ndërkombëtare të kërkuara nga autoriteti kontraktor për këto produkte.
- k) Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi (produktet me nr.5 dhe nr.6 në tabelën e shtojcës Nr.12) për të cilat kërkohen standarte kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara dhe të pasqyruara në Shtojcën Nr.10 Specifikimet Teknike, duhet të paraqesë raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve kombëtare ose ndërkombëtare të kërkuara.
- l) Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) copë në paketim origjinal për secilin prej produkteve objekt i këtij prokurimi sipas tabelës në Shtojcën Nr.12.
 - Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.
 - Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

1. Sapun i lëngshëm duarsh

Ky produkt të jetë me efekt shkumues të menjëhershëm dhe të realizojë pastrim efikas të duarve falë përqendrimit të duhur të tensioaktivëve anionikë. Produkti duhet që pas përdorimit t'i lerë duart të hidratuara pas përdorimit falë agentëve të tij emolientë.

Përbërja kimike:

- Të ketë prezencë të lëndës aktive të tensioaktivit anionik në jo më pak se 5% të vëllimit të produktit.
- Të ketë prezencë në 0.1% - 1% të vëllimit të produktit tensioaktivë anfoterë.
- Të ketë prezencë në 0.1% - 1% të vëllimit të produktit tensioaktivë me origjinë vegjetale.
- Të ketë në përbërje jo më pak se një produkt emolient me bazë bimore.
- Jetëgjatësia jo më pak se 12 muaj nga koha e lëvrimit.
- Paketimi në bidona plastikë 0.5 -1 litra me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

2. Solucion për dezinfektimin e sipërfaqeve

Ky produkt me bazë klorurin e benzalkonit duhet të përdoret për higjienizimin e sipërfaqeve të ndryshme të mobiljeve, dymëve, dritareve, bankave, katedrave etj. Produkti duhet të higjienizojë në mënyrë të sigurtë sipërfaqet e ndryshme duke pasur në përbërje të tij tensioaktivë jo-jonikë dhe përbërës të tjerë të cilët rrisin gamën e veprimtë të tij në sa më shumë faktorë mikrobiotikë, viralë dhe fungicidë.

Përbërja kimike:

- Klorur benzalkoni, CAS-68424-85-1 ku të ketë prezencë 1-5% të vëllimit të produktit.
- Alkool benzilik CAS-76-93-7 ose ekuivalentin e tij ku të ketë prezencë në 0.1- 1% të vëllimit të produktit.

- Të ketë në përbërje të paktën një konservues bakteriostatik.
- Tensioaktivë jo-jonikë 0.1- 1% të vëllimit të produktit.
- EDTA 0.1-1% të vëllimit të produktit.
- Jetëgjatësia jo më pak se 12 muaj nga koha e lëvrimit.
- Paketimi në bidona plastikë 0.5-1 litra me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

3. Solucion dezinfektant dhe antiseptik me bazë alkooli

Ky produkt me bazë alkooli duhet të përdoret për higjenizimin e duarve në të gjitha situatat kur kërkohet pastrimi dhe higjenizimi i duarve pa qenë i nevojshëm përdorimi i ujit dhe sapunit. Gjithashtu ky produkt duhet të përdoret me efikasitet dhe në dezinfektimin e instrumenteve, pajisjeve të palestrave, pajisjeve të kabineteve mësimorë etj. Produkti duhet të higjenizojë në mënyrë të sigurtë epidermën e duarve duke pasur në përbërje të tij alkool etilik dhe përbërës të tjerë të cilët rrisin gamën e veprimit të tij në sa më shumë faktorë mikrobiotikë, viralë dhe fungicidë. Produkti duhet të thahet në mënyrë të shpejtë në ajër dhe t'i lerë duart të hidratuara pas përdorimit falë agjentëve të tij emolientë me bazë bimore.

Përbërja kimike:

- Të ketë prezencë në jo më pak se 60% të vëllimit të produktit alkool etilik me përqendrim 95%, CAS 64-17-5.
- Glukonat i klorhexidinës, CAS-18472-51-0 ose ekuivalentin e tij, me prezencë në 0.1-1% të vëllimit të produktit.
- Të ketë në përbërje të paktën një produkt emolient me bazë bimore.
- Jetëgjatësia jo më pak se 12 muaj nga koha e lëvrimit.
- Paketimi në bidona plastikë 0.5-1 litra me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

4. Xhel antiseptik për higjenizimin e duarve

Ky produkt alkoolik xhel, të jetë me efekt antiseptik për higjenizimin e duarve duke vepruar me efikasitet kundër faktorëve mikrobialë, viralë dhe fungicidë. Produkti duhet të thahet në mënyrë të shpejtë në ajër dhe t'i lerë duart të hidratuara pas përdorimit falë agjentëve të tij emolientë.

Përbërja kimike:

- Të ketë prezencë në jo më pak se 60% të vëllimit të produktit alkool etilik me përqendrim 95%, CAS 64-17-5.
- Të ketë në përbërje të paktën një konservues bakteriostatik.
- Të ketë në përbërje jo më pak se dy produkte emolientë me bazë bimore.
- Jetëgjatësia jo më pak se 12 muaj nga koha e lëvrimit.
- Paketimi në bidona plastikë 0.5 - 1 litra me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

5. Maska respiratore me nivel mbrojtës FFP2

Maskë respiratore me nivel mbrojtje FFP2 ose ekuivalente, me ose pa valvul, me një përdorim, me lidhëse pas veshit ose pas kokës, të mbrojë hundën dhe gojën, të puthitet lehtësisht me fytyrën dhe hundën, të mos shkaktojë probleme me frymëmarrjen, të ketë përshkueshmëri të mirë të ajrit, me nivel filtrimi të ajrit $\geq 95\%$, hipoalergjike, pa fibra qelqi, të jetë rezistente ndaj agjentëve biologjikë, aerosoleve, yndyrnave, ujit, etj. Afati i skadencës të jetë të paktën 6 muaj nga dita e lëvrimit. Të jenë të amabalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes. Të ketë çertifikimin CE/FDA ose ekuivalent. Të jenë konform standartit shqiptar SSH EN 149:2001+A1:2009 ose ekuivalenti i tij.

Karakteristikat teknike:

- Lartësia: $\geq 15\text{cm}$
- Gjerësia: $\geq 20\text{cm}$
- Paketimi: Në kuti kartoni jo më shumë se 50 copë

6. Maska mbrojtëse kirurgjikale njëpërdorimëshe

Maskë kirurgjikale e thjeshtë, me një përdorim, me lidhëse pas veshit ose pas kokës, të mbrojë hundën dhe gojën, me përshtatës për hundën, të mos shkaktojë probleme me frymëmarrjen, të ketë përshkueshmëri të mirë të ajrit, me nivel filtrimi të ajrit $\geq 99\%$, hipoalergjike, me copë të pathurur me 3 shtresa me palosje, celulozë, polietër, fibër, me formë drejtkëndëshe e sheshtë, me nivel të mirë mbrojtjeje. Afati i skadencës të jetë të paktën 6 muaj nga dita e lëvrimit. Të jenë të amabalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes. Të jenë konform standartit shqiptar SSH EN 14683:2019+AC:2019 ose ekuivalenti i tij.

Karakteristikat teknike:

- Gjatësia: $180\text{mm} \pm 10\text{mm}$
- Gjerësia: $90\text{mm} \pm 10\text{mm}$
- Paketimi: Në kuti kartoni jo më shumë se 50 copë

7. Termometër dixhital infrared

Të realizojë matjen e temperaturës së trupit të njeriut në një distancë matje 3-5 cm;

Të ketë diapazon matje $32^\circ\text{C} - 42.9^\circ\text{C}$

Me rezolucion matje (të pasqyruar në ekranin dixhital) $0.1^\circ\text{C}/0.1^\circ\text{F}$.

Në lagështi relative $\leq 90\%$

Saktësia sipas standartit ASTM E1963-1998 (2003) ose ekuivalent:

- $35-42^\circ\text{C} (\pm 0.2^\circ\text{C})$

Termometri të ketë mundësi ushqimi me bateri të ndërrueshme.

Të ketë çertifikimin CE/FDA ose ekuivalent. Të plotësojë Standartin Shqiptar SSH EN 60601-1-2:2015 ose ekuivalentin e tij, për pajisjet elektrike mjekësore, kërkesa të përgjithshme për sigurinë bazë dhe performancën e nevojshme. Të ofrohet me garanci të paktën 12 muaj nga koha e lëvrimit.

8. Doreza një përdorimëshe

Doreza latex natyral ose nitrile, jo sterile, një përdorimëshe, të jenë të paketuara në pako kartoni me minimumi 100 copë doreza. Të ketë certifikimin CE/ FDA ose ekuivalent. Afati i skadencës të jetë të paktën 6 muaj nga dita e lëvrimit. Të jenë të amabalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.

Karakteristikat teknike:

Përbërja: lateks natyral, veshja e brendshme: polimer

Gjatësia: jo më e vogël se 240 mm

Trashësia: jo më e vogël se $0.1\text{mm} \pm 0.02\text{mm}$

9. Vasketa inoksi për dezinfektim në objektet arsimore

Vasketa inoksi të cilat do të montohen në hyrje të objekteve arsimore dhe publike sipas kërkesave të autoritetit kontraktor me qëllim dezinfektimin e këpucëve para hyrjes në objekt.

Karakteristikat teknike:

Spesori: jo më pak se 0.8mm

Densiteti i materialit (*çelik i pandryshkshëm inoks*): jo më pak se 7.9 g/cm^3

Dimensionet: Gjatësia $100 \text{ cm} \pm 5\text{cm}$ x Gjerësia $60\text{cm} \pm 2 \text{ cm}$ x Thellësia $5\text{cm} \pm 0.5\text{cm}$

Tehet e vasketës të jenë të kthyera nga brenda 180° , jo më pak se 2.5 cm tek të gjitha kahet, për të eliminuar ndonjë dëmtim të mundshëm gjatë shkeljes.

Çdo vasketë të shoqërohet secila me vida/fasheta fiksuese për fiksimin në dysheme dhe ruajtjen e produktit nga dëmtimi dhe rrjedhjet e mundshme dhe me një sfungjer me dendësi të lartë me karakteristikat teknike të përcaktuara për produktin me nr.10 në tabelën e Shtojcës Nr.12. Të ofrohet me garanci të paktën 12 muaj nga koha e lëvrimit.

Standartet që duhet të plotësojë:

- Standarti Shqiptar SH EN 10028-7:2016 ose ekuivalenti i tij për çeliquet e paoksidueshëm.
- Standarti Shqiptar SH EN 10088-2:2014 ose ekuivalenti i tij për fletë, pllaka dhe shirit çeliku inox për qëllime të përgjithshme.

10. Sfungjer për vasketat e inoksit

Sfungjer duhet të jetë me dendësi të lartë me karakteristikat teknike si më poshtë:

Densiteti: $\geq 40 \text{ kg/m}^3$

Fortesia ILD: $\geq 195\text{N}$

Zgjatimi: $\geq 130\%$

Elasticiteti: $\geq 64 \%$

Sfungjeri të ketë përmasa, sipas dimensioneve të vasketës (produkti me nr.9 në tabelën e Shtojcës Nr.12):

Gjatësia: $100 \text{ cm} \pm 5\text{cm}$

Gjerësia: $60\text{cm} \pm 2 \text{ cm}$

Trashësia: 2-3 cm

Sfungjeri duhet të ketë përmbajtje polimeri poliuretani. Çdo sfungjer duhet të shoqërohet me lëndën ngjitëse që do të bëjë të mundur ngjitjen e sfungjerit me tabanin e vasketës. Lënda ngjitëse duhet të sigurojë një ngjitje të sigurtë duke garantuar mos shkëputjen pas ngopjes së sfungjerit me solucion dhe përdorimit të saj në shkelje. Sfungjeri duhet të jenë konform Standartit CE dhe të plotësojë Standartin Shqiptar SSH EN ISO 2439:2008 ose ekuivalentin e tij.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mallrat do të lëvrohen të shoqëruara me garancitë përkatëse (të përcaktuara në DST dhe në kontratë) në marrëveshjen e përcaktimit të kushteve të garancisë, para lidhjes së kontratës do të definohen dhe mënyrat, koha, dhe çdo specifikim tjetër i vlefshëm dhe i detyrueshëm për palët kontraktuese. Të gjitha mallrat të cilat do të lëvrohen nga operatori ekonomik fitues duhet të jenë patjetër konform ofertës teknike të ofruar dhe të depozituar duke përfshirë cilësitë teknike dhe markën e prodhuesit.

Furnizimi bëhet me mjetet e furnizuesit në çdo objekt parashkollor dhe shkollor sipas kërkesës të Autoritetit Kontraktor në sasi, lloj dhe kohë brenda afatit të përcaktuar në çdo minikontratë të lidhur nga data e nënshkrimit. Lloji dhe sasia e mallrave objekt prokurimi që do të shpërndahen do të përcaktohen qartë nga Autoritetit Kontraktor për çdo objekt shkollor dhe parashkollor në planin e shpërndarjes i cili do të vihet në dispozicion të operatorit ekonomik fitues ditën e nënshkrimit të çdo minikontrate.

Shtojca11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Kuadër _____	☐ Mall:	Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 12*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)***SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT****Sasia e mallit që kërkohet:**

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia Totale	Afati i lëvrimit
1	Sapun lëng	litra	432 415	24 muaj
2	Solucion dezinfektant për sipërfaqet	litra	40 962	24 muaj
3	Solucion dezinfektant me bazë alkooli	litra	8 000	24 muaj
4	Xhel antiseptik për higjenizimin e duarve	litra	116 080	24 muaj
5	Maska respiratore me nivel mbrojtës FFP2	copë	7 200	24 muaj
6	Maskë kirurgjikale e thjeshtë me një përdorim	copë	190 740	24 muaj
7	Doreza plastike një përdorimëshe	copë	381 500	24 muaj
8	Termometër dixhital infrared	copë	240	24 muaj
9	Vasketa inoki për dezinfektimin	copë	120	24 muaj
10	Sfungjer për vasketat e inoksit	copë	1 968	24 muaj

Afatet e lëvrimit: 24 (njëzet e katër) muaj nga nënshkrimi i kontratës

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it
Vlera _____	
(me numra dhe fjalë)	

2. _____	_____
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it
Vlera _____	
(me numra dhe fjalë)	

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____	_____
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it
2. _____	_____
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
----------	-------

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME **Mallrat – Tender i Hapur**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikët e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korrupsive. Veprimet korrupsive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezultojnë një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
